



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



Departamenti Special

PS.nr.14/23

Më dt.11.12.2023

FTESË PËR SEANCË

Ftohet i akuzuari Dejan Raciq, nga i ati Janko, i lindur në fshatin Videj, Komuna Klinë, me vendbanim të panjohur, me nacionalitet serb, ish pjesëtarë i forcave rezervë ushtarake të Serbisë, me numër personal 0101974932041 i lëshuar nga Sekretariati i Punëve të Brendshme në Klinë, të marrë pjesë në seancë fillestare të caktuar më dt.20.02.2024, e martë, në ora 9:30, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, për çështjen penale të proceduar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.17/2018 të dt.27.11.2023, për shkak se i njëjti dyshohet të ketë kryer veprën penale Krime Luftë kundër popullsisë civile nga neni 142 të Kodit penal të Jugosllavisë, aktualisht e inkriminuar si Krimet kundër njerëzimit nga neni 143 par.1 nënpar.1.7 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Konform nenit 303 par.8 të KPPRK-së gjykata i bënë thirrje të akuzuarit Dejan Raciq, të dorëzohet dhe të paraqitet sa më parë pranë kësaj gjykate, që kjo çështje penale të zhvillohet me prezencën e tij në seancën e caktuar më datë dhe në kohë si më lartë.

Konform nenit 303 par.8 të KPPRK-së, gjykata i bënë thirrje çdo personi që ka informacion relevant për vendndodhjen e të akuzuarit Dejan Raciq, që t'ia komunikojë atë informacion policisë së Kosovës, me qëllim të sigurimit të prezencës së akuzuarit Dejan Raciq në këtë çështje juridiko penale.

Bashkangjitur: Aktakuza e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.17/2018, të datës 27.11.2023, e ushtruar kundër të akuzuarit Dejan Raciq, për shkak të veprës penale si më lartë.



Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari
Vesël Ismaili